



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE

II. Zëvendëskryetari i Akademisë
(Kriteret e dhe procedurat)

Mbështetur: **1.** Ligjit nr. 9655 datë 11.12.2006 *Për Akademinë e Shkencave të Rreplikës së Shqipërisë*, neni 11, *Mënyra e zgjedhjes së Kryesisë* (ndryshuar me Ligjin nr. 9853, datë 26.12.2007, neni 7); **2.** *Statutit organik të saj*, neni 17 dhe neni 18; **3.** *Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*;

Duke qenë se funksioni i Zëvendëskryetarit është vakant që nga muaji shtator 2017;

Përmes kësaj thirrjeje publike ftohen për konkurrim anëtarët e Asamblesë me titullin *akademik, akademik i përhershëm ose akademik i asociuar*.

I. Kërkesa për dokumentacion:

Sipas procedurës së parashikuar në Statut, kandidatët duhet të paraqesin pranë Akademisë së Shkencave:

1. Kërkesë vetjake për aplikim drejtuar Asamblesë së Akademisë së Shkencave;
2. Fotokopje të kartës së identitetit / pasaportës;
3. Curriculum Vitae;
4. Listë të studimeve të botuara (monografi, artikuj);
5. Platformë për drejtimin e Akademisë së Shkencave gjatë mandatit të tij;
6. Formular aplikimi për informim për zyrtarët para emërimit / zgjedhjes në poste të larta (sipas nenit 29, pika 1, germa gj, të Ligiit nr. 45/2015 *Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*);

7. Formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit konfirmohet mosekzistenca e shkaqeve penguese për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar, sipas Ligjit nr. 138/2015 *Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*. Formulari gjendet në webin e Akademisë së Shkencave, në linkun e mëposhtëm:

<http://akad.gov.al/ash/legjislacioni/formular-vetedeklarimi>

II. Kalendar i procesit zgjedhor:

1. Pranimi i dokumentacionit për konkurrim është nga data 10 prill 2019 deri më 10 maj 2019.
2. Procesi i verifikimit në rrugë institucionale të garancive ligjore sipas pikave 6 dhe 7, nga data 10 deri më 15 maj 2018;
3. Mbledhja e Asamblesë për votimin e kandidaturave do të zhvillohet më 24 maj 2019, ora 10.00, në sallën *Aleks Buda*.
4. Para votimit kandidatët do të paraqesin projektin e tyre për drejtimin e institucionit. Koha në dispozicion të çdo kandidati është 15 minuta. Anëtarët e Asamblesë kanë të drejtë të bëjnë pyetje rreth projekteve.

III. Procedura e konkurrimit dhe e votimit:

1. Kandidatë për funksionin e Zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave mund të jenë *anëtarët e rregullt, anëtarët e përhershëm ose anëtarët e asociuar* të Asamblesë.
2. Zgjedhja e Zëvendëskryetarit bëhet me votim të fshehtë, në mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë, pa debat.
3. Shpallet i zgjedhur në funksionin e Zëvendëskryetarit kandidati që fiton shumicën absolute (50 për qind +1) të votave të gjithë anëtarëve të Asamblesë.
4. Në rast se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet për dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota.
5. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet dhe fitues shpallet kandidati me 50 për qind + 1 të anëtarëve Asamblesë të pranishëm në votim.
6. Mandati në detyrë është 4-vjeçar dhe fillon ditën e zgjedhjes nga Asambleja. Mandati i Zëvendëskryetarit nuk përsëritet dy herë rresht.

IV. Detyrat e Zëvendëskryetarit të Akademisë, sipas rregullores së brendshme të Akademisë së Shkencave, kreu III, *Funksionet drejtuese*, neni 8, janë:

Zëvendëskryetari është zëvendëstitullar i Akademisë së Shkencave dhe anëtar i Kryesisë, i zgjedhur nga Asambleja e saj. Ai ka këto detyra:

- Ndjek dhe bashkërendon punën e seksioneve;
- Miraton programet e veprimtarisë së tyre kryesore organizative;
- Ndhmon në mbarëvajtjen e punës të Seksioneve;
- Zëvendëson dhe përfaqëson Kryetarin në mungesë të tij për çështje të veçanta dhe për drejtimin e gjithë veprimtarisë së Akademisë me autorizim të tij, për një periudhë të përkohshme, në përputhje me Ligjin dhe me Statutin e Akademisë së Shkencave;
- Kryen detyra të tjera të caktuara me urdhër të Kryetarit;
- Nënshkruan akte dhe dokumente që u drejtohen organeve qendrore të administratës shtetërore, përcaktuar paraprakisht me autorizim të Kryetarit;
- Kryen veprimtari kërkimore-shkencore vetjake.